

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES

AGJENCIA E AKREDITIMIT TE ARSIMIT TE LARTE

Bulevardi "Zhan D' Dark", Pallatet e Lanës, Nr. 2, Ap 17, Tiranë

Tel&Fax: 2257 954/2266 302/2225 322

Axhenda Tip e vizitës së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm në Institucionin e Arsimit të Lartë që vlerësohet në kuadrin e Procesit të Akreditimit Institucional dhe të Programeve të Studimit

Axhenda e takimeve dhe e vëzhgimeve që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kryen në një institucion në kuadrin e procesit teresor të vlerësimit në kuadrin e akreditimit duhet të përfshijë detyruesisht aktivitetet e mëposhtme :

1. Takim me titullarin me të lartë (Rektorin) e Institucionit të Arsimit të Lartë
2. Takim me Dekanin e Fakultetit/eve që janë në vlerësim si dhe përgjegjësit e departamenteve të tyre.
3. Takim me Grupin e Vetëvlerësimit ; pyetje , diskutime mbi raportin e vetëvlerësimit, organizimit dhe zhvillimit si dhe gjithspërfshirjes e transparenca në proces
4. Takim me stafin akademik (efektiv dhe me kontratë) që mbulojnë programin/et e studimit (pyetje, transparenca e procesit të vetëvlerësimit dhe përfshirja e tij)
5. Vëzhgimi dhe analiza e mjediseve në kuadrin e programeve dhe institucionit që vlerësohet si dhe numrit të studenteve; klasat; labororet; bibliotekat; shërbimet për studentët etj.
6. Takime dhe vizita me me stafin administrativ të institucionit, kancelarin, Zyren e Burimeve Njerezore, sekretaritetë mësimore dhe administratën e universitetit/fakultetit/departamentit; takime dhe vizita eventuale me Zyrën Juridike, Zyra e Informacionit, Zyrën e Kurrikulave, Zyrën e Statistikave lidhur me të dhënat e IAL, studentët, transparenca ndaj publikut, aksesit të studentëve në informacion etj.
7. Takim dhe intervista me studentet përfaqësues të të gjitha programeve që janë në vlerësim; intervistat duhet të bëhen të hapura si dhe me shkrim në mënyrë anonime. Formularet mbledhen dhe me pas përpunohen nga ekspertët e vlerësimit. Mendimet dhe sugjerimet e studenteve duhet të reflektohen në raportin e vlerësimit të ekspertëve.

8. Takim mbyllës me titullarët e Institucionit ku paraqiten (shkurt) gjetjet kryesore të grupit të vleresimit të jashtëm.

Me kerkese të grupit të vleresimit mund të zhvillohen edhe takime të tjera që janë në funksion të plotesimit të procesit të vleresimit.

Shënim :

Kjo axhende mund të pesoje ndryshime e përmirësime në funksion të ndryshimeve ligjore e nenligjore, apo nisur nga praktika e mirë kombëtare dhe nderkombëtare